

**Procesverbal**  
**Mbledhja e radhës së Këshillit Bashkiak Skrapar**  
**Mbajtur më datë 28.04.2026**

**Ora e hapjes së mbledhjes sipas njoftimit 10:00, vendi i mbajtjes së mbledhjes : Salla e mbledhjeve e Këshillit Bashkiak Skrapar, Qendra Kulturore “Riza Cerova” Kati i Dytë.**

**Listëprezenca e Këshilltarëve pjesëmarrës në momentin e hapjes së mbledhjes.**

1. ALMA KADIASI
2. ARJAN HASA        m
3. ALBANA HOXHA
4. EDMOND KALEMI
5. ELSA PETRITAJ
6. ERAJD ZAIMI        m
7. ENVER CAKA
8. FIKRET TELHA     m
9. LIRI NUHELLARI    m
10. MIMOZA HYSAJ
11. MIMOZA ZYLYFTARI   m
12. MYQERRET HEBIBASI
13. PËLLUMB GURI
14. SKERDILAJT JAUPLLARI
15. VALBONA GROPA

**Sekretare e Këshillit** deklaroi kuorumin prej 10 Këshilltarësh.

Në mbledhje ishin të pranishëm:Nën/Kryetarja e Bashkisë znj.Sonila Hysenbelliu, përfaqësues të administratës, të cilët kanë hartuar projekt-vendimet që do të merren në shqyrtim

**Kryetare Këshillit deklaroi hapjen e mbledhjes duke kaluar në pikën 1, miratimi i rendit të ditës sipas njoftimit të bërë me nr. 13 prot. të datës 22.04.2026.**

Kryetare e Këshillit kërkoi nga anëtarët e këshillit mirëkuptimin për të futur në rendin e ditës dy projekt-vendime shtesë “Për miratimin në parim të vendosjes së një lapidari përkujtimor në nderim të 10 Dëshmorëve të Atdheut” dhe “Për miratimin e planit të masave për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në fondin pyjor e kullosor për vitin 2026, në bashkinë Skrapar.”

Me leje fjalën e mori z.Pëllumb Guri i cili shprehu padakortësi që këto dy project-vendime të futen në rend dite për arsye sepse anëtarët nuk kanë pasur kohën e duhur për ti shqyrtuar. E mira është që të lihen për mbledhjen e ardhshme pasi dhe ne të kemi mundësi ti studiojmë të njihemi me problemin. Dokumentacioni duhet të vi 5 ditë para, përherë të njejtin problem na i lini mbi tavolin se ça është shkuar ne se dimë.

Me leje fjalën e mori znj. Rudina Llango e cila shpreh nëse i referohemi dokumentacionit bashkëlidhir project-vendimit gjithçka është e vërtetuar, dhe po ti shikoni emërtimet përkatëse janë dëshmorë të atdheut. Kjo është bërë nga një grup nismëtarësh për të vendosur këta lapidarë. Nëse keni dokumentacionin përpara nuk ka nevojë shumë për tu diskutuar duke parë dhe informacionin që keni në muzeun historik.

Me leje fjalën e mori z.Pëllumb Guri i cili shprehu nëse nuk ka nevojë për diskutim pse na e sillni ta votojmë ne, bëheni pa miratimin tonë. Mos zbatoni ligjin, bëni si të doni.

Kryetare e Këshillit deklaroi hapjen e votimit për miratimin e rendit të ditës sipas njoftimit.  
Ora 10:10

Vota pro: 8, Alma Kadiasi, Edmond Kalemi, Elsa Petritaj, Enver Caka, Mimoza Hysaj, Myqerret Hebibasi, Skerdilajt Jaupllari, Valbona Gropa.

Vota KUNDËR: 1 Pëllumb Guri

Vota ABSTENIM: 1 Albana Hoxha

**Pika 2 e rendit të ditës , Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Konstituimit të Këshillit Bashkiak, datë 26.03.2026 dhe 31.03.2026.**

Kryetare Këshillit u drejtoi pyetjen këshilltarëve nëse ka dikush për të shtuar diçka në lidhje me procesverbalin i cili u është vënë në dispozicion çdo këshilltari së bashku me materialet e mbledhjes së radhës.

Këshilltarët shprehin dakortësi .

Kryetare e Këshillit deklaroi hapjen e votimit për miratimin e procesverbalit të mbledhjes së mëparshme . Ora 10:15

Vota pro: 10, Alma Kadiasi, Albana Hoxha, Edmond Kalemi, Elsa Petritaj, Enver Caka, Mimoza Hysaj, Myqerret Hebibasi, Pëllumb Guri, Skerdilajt Jaupllari, Valbona Gropa.

Vota KUNDËR: s'ka

Vota ABSTENIM: s'ka

### **Pika 3 deklarimet e konfliktit të interesave**

Kryetare Këshillit drejton pyetjen në se ka konflikt interesi nga këshilltarët për çështjet që do të merren në shqyrtim.

Për çështjet që do të merren në shqyrtim asnjë nga anëtarët e këshillit nuk ka shprehur konflikt interesi.

### **Pika 4 e rendit të ditës "Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi kushtëzuar 6% për muajin Mars 2026".**

Kryetare Këshillit deklaroi shqyrtimin e projektvendimit

Me leje fjalën e mori znj.Teuta Hysenbelliu e cila prezantoi projektvendimin sipas relacionit bashkëlidhur.

Kryetare Këshillit drejton pyetjen nëse ka pyetje diskutime rreth çështjes?

Me leje fjalën e mori z.Pëllumb Guri i cili pyet pse është përjashtuar një familje? A e ka bërë shpërnguljen ky zotëria?

Me leje fjalën e mori znj.Teuta Hysenbelliu e cila shprehu se ai është larguar për në Tiranë bashkë me fëmijët dhe bashkëshorten, shpërnguljen nuk e ka bërë. Në momentin që ikën familjarisht në një qytet tjetër nuk mund ta mari dot më ndihmën ekonomike, sepse kur vjen kontrolli ose dhe vet punonjësi kur vete të bëji verifikimin nuk mund të deklaroj dot që e kam në fshat kur nuk është. Dhe në janar ka firmosur rigjenerimin e deklaratës, pastaj nuk e mban dot më punonjësi. Nuk lejohet me ligj sepse dhe sikur, dalin fëmijët të rregjistruar në shkollë diku tjetër. Nëqoftëse do ishte vetëm kryefamiljari atëherë ai duhej të deklaronte pagën dhe pjesa tjetër e familjes që do ishte në fshat do e merte ndihmën ekonomike. Ai ka ikur për një jetë më të mirë.

Me leje fjalën e mori z.Pëllumb Guri i cili shprehu se ai është larguar sepse bashkia nuk i ka ofruar asnjë gjë.

Me leje fjalën e mori znj.Teuta Hysenbelliu e cila shprehu se kemi bërë tolerime kur ikën një person i familjes por kur ikën e gjithë familja nuk kemi se çfarë të bëjmë.

Me leje fjalën e mori z.Pëllumb Guri i cili shprehu dhe për një familje tjetër z.Adrian përse është hequr?

Me leje fjalën e mori znj.Teuta Hysenbelliu e cila shprehu se nuk është hequr por ka bërë ndarje abuzive, ka ndarë fëmijën mbi 18 vjeç. Kishte shkuar tek punonjësi i qendrës dhe ai i kishte thënë mos e ndaj. Në qoftë se ndan një kurorë nëse fëmija krijonte martesë atëherë familja merte ndihmë ekonomike, ai e ka ndarë për qëllime për të filluar punë, ikën jashtë shtetit nuk e dimë por penalizohet familja, ai është sqaruar për këtë gjë.

Me leje fjalën e mori z.Pëllumb Guri i cili shprehu se fëmija kur mbush 18 vjec është i lirë të bëjë çfarë të doji

Me leje fjalën e mori znj.Teuta Hysenbelliu e cila shprehu e di si funksionon por ligji kështu është, vetëm kur ndahen me kurorë atëherë nuk përjashtohen familjet.

Kryetare e Këshillit deklaroi hapjen e votimit për miratimin e projektvendimit. Ora 10:25

Vota pro: 10, Alma Kadiasi, Albana Hoxha, Edmond Kalemi, Elsa Petritaj, Enver Caka, Mimoza Hysaj, Myqerret Hebibasi, Pëllumb Guri, Skerdilajt Jaupllari, Valbona Gropa.

Vota KUNDËR: s'ka

Vota ABSTENIM: s'ka

**Pika 5 e rendit të ditës “Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondet e Bashkisë Skrapar për muajin Mars 2026”.**

Kryetare Këshillit deklaroi shqyrtimin e projektvendimit

Me leje fjalën e mori znj.Teuta Hysenbelliu e cila prezantoi projektvendimin sipas relacionit bashkëlidhur.

Kryetare Këshillit drejton pyetjen nëse ka pyetje diskutime rreth çështjes?

Kryetare e Këshillit deklaroi hapjen e votimit për miratimin e projektvendimit. Ora 10:30

Vota pro: 10, Alma Kadiasi, Albana Hoxha, Edmond Kalemi, Elsa Petritaj, Enver Caka, Mimoza Hysaj, Myqerret Hebibasi, Pëllumb Guri, Skerdilajt Jaupllari, Valbona Gropa.

Vota KUNDËR: s'ka

Vota ABSTENIM: s'ka

**Pika 6 e rendit të ditës “Mbi dhënien e ndihmës financiare nga Bashkia Skrapar për shtetasen Drita Qafoku”.**

Kryetare Këshillit deklaroi shqyrtimin e projektvendimit

Me leje fjalën e mori znj.Teuta Hysenbelliu e cila prezantoi projektvendimin sipas relacionit bashkëlidhur.

Kryetare Këshillit drejton pyetjen nëse ka pyetje diskutime rreth çështjes?

Me leje fjalën e mori z.Pëllumb Guri i cili shprehu se janë shumë dakort me dhënien e ndihmave por ama doja dhe diçka tjetër. Pse mos tu jepet edhe nxënësve ndihmë sociale, nxënësve që janë të talentuar pavarësisht kanë apo kanë lekë por ua japim vetëm të sëmurëve, të shikohet brezi i ri.

Me leje fjalën e mori Kryetarja e Këshillit znj.Elsa Petritaj e cila ishte dakort me mendimin e z. Pëllumb që të motivohen pak nxënësit jo vetëm për shkollën e mesme por edhe 9-vjeçarët.

Me leje fjalën e mori Nën/Kryetarja e Bashkisë znj.Sonila Hysenbelliu e cila shprehu se në djenin e saj Kryetari i Bashkisë e ka pasur këtë nismë para dy vitesh, por realizimi nuk plotësonin kriteret nxënësit, sepse kudo pyetëm duhet të ishin me 10 absolutë, në të treja shkollat nuk kishte nxënës 10 absolutë.

Me leje fjalën e mori dhe Kryetarja e Këshillit e cila shprehu se ishte diçka që nuk shkon pasi një nxënës mund të ketë një talent shumë të mirë në matematik nuk është e thënë ta ketë 10 dhe historinë, prap i talentuar është.

Me leje fjalën e mori Nën/Kryetarja e Bashkisë e cila shprehu se nëse flasim për të motivuar nxënës që janë të shkëlqyer në mësimet duhet të jenë kudo 10. Po të kemi shumë të apasionuar pas sporteve i bie që të stimulojmë ata të sporteve dhe ata të tjerët mos ti motivojmë.

Me leje fjalën e mori znj.Albana Hoxha e cila shprehu se kur është 9.9 nuk e stimulojmë dot ta çojmë tek 10-ta?

Me leje fjalën e mori znj.Rudina Llango e cila shprehu se nuk mund ta stimulojmë sepse janë shumë nxënës të gjithë kanë prirjet e veta , nuk do të thotë që të gjithë të marrin përkrahje nga bashkia, sepse të gjithë ata nevojë për stimulim kanë, por duhet të jenë me 10 absolute.

Me leje fjalën e mori z.Pëllumb Guri i cili shprehu se kam edhe diçka çfarë do bëjmë me fondet e këshillit sepse është viti i tretë dhe ne skemi bërë asgjë.

Me leje fjalën e mori dhe Kryetarja e Këshillit e cila shprehu do bëhet dhe do e vendosim të gjithë bashkë.

Kryetare e Këshillit deklaroi hapjen e votimit për miratimin e projektvendimit. Ora 10:40

Vota pro: 10, Alma Kadiasi, Albana Hoxha, Edmond Kalem, Elsa Petritaj, Enver Caka, Mimoza Hysaj, Myqerret Hebibasi, Pëllumb Guri, Skerdilajt Jaupllari, Valbona Gropa.

Vota KUNDËR: s'ka

Vota ABSTENIM: s'ka

### **Pika 7 e rendit të ditës “Mbi dhënien e ndihmës financiare nga Bashkia Skrapar për shtetasin Përparim Qafoku”.**

Kryetare Këshillit deklaroi shqyrtimin e projektvendimit

Me leje fjalën e mori znj.Teuta Hysenbelliu e cila prezantoi projektvendimin sipas relacionit bashkëlidhur.

Kryetare Këshillit drejton pyetjen nëse ka pyetje diskutime rreth çështjes? jo

Kryetare e Këshillit deklaroi hapjen e votimit për miratimin e projektvendimit. Ora 10:45

Vota pro: 10, Alma Kadiasi, Albana Hoxha, Edmond Kalemi, Elsa Petritaj, Enver Caka, Mimoza Hysaj, Myqerret Hebibasi, Pëllumb Guri, Skerdilajt Jaupllari, Valbona Gropa.

Vota KUNDËR: s'ka

Vota ABSTENIM: s'ka

**Pika 8 e rendit të ditës “Mbi dhënien e ndihmës financiare nga Bashkia Skrapar për shtetasen Eljona Jaupllari”.**

Kryetare Këshillit deklaroi shqyrtimin e projektvendimit

Me leje fjalën e mori znj. Teuta Hysenbelliu e cila prezantoi projektvendimin sipas relacionit bashkëlidhur.

Kryetare Këshillit drejton pyetjen nëse ka pyetje diskutime rreth çështjes? jo

Kryetare e Këshillit deklaroi hapjen e votimit për miratimin e projektvendimit. Ora 10:50

Vota pro: 10, Alma Kadiasi, Albana Hoxha, Edmond Kalemi, Elsa Petritaj, Enver Caka, Mimoza Hysaj, Myqerret Hebibasi, Pëllumb Guri, Skerdilajt Jaupllari, Valbona Gropa.

Vota KUNDËR: s'ka

Vota ABSTENIM: s'ka

**Pika 9 e rendit të ditës “Mbi dhënien e ndihmës financiare nga Bashkia Skrapar për shtetasin Besnik Ylli”.**

Kryetare Këshillit deklaroi shqyrtimin e projektvendimit

Me leje fjalën e mori znj. Teuta Hysenbelliu e cila prezantoi projektvendimin sipas relacionit bashkëlidhur.

Kryetare Këshillit drejton pyetjen nëse ka pyetje diskutime rreth çështjes? jo

Kryetare e Këshillit deklaroi hapjen e votimit për miratimin e projektvendimit. Ora 10:55

Vota pro: 10, Alma Kadiasi, Albana Hoxha, Edmond Kalemi, Elsa Petritaj, Enver Caka, Mimoza Hysaj, Myqerret Hebibasi, Pëllumb Guri, Skerdilajt Jaupllari, Valbona Gropa.

Vota KUNDËR: s'ka

Vota ABSTENIM: s'ka

**Pika 10 e rendit të ditës “Për miratimin në parim te vendosjes së një lapidari përkujtimor në nderim të 10 Dëshmorëve të Atdheut.”**

Kryetare Këshillit deklaroi shqyrtimin e projektvendimit

Me leje fjalën e mori znj.Rudina Llago e cila prezantoi projektvendimin sipas relacionit bashkëlidhur.

Kryetare Këshillit drejton pyetjen nëse ka pyetje diskutime rreth çështjes?

Me leje fjalën e mori z.Myqerret Hebibasi i cili pyet se pse nuk është bërë më parë?

Me leje fjalën e mori znj. Rudina Llago e cila shpreh se nuk ka pasur kërkesa.

Kryetare e Këshillit deklaroi hapjen e votimit për miratimin e projektvendimit. Ora 11:00

Vota pro: 9, Alma Kadiasi, Albana Hoxha, Edmond Kalem, Elsa Petritaj, Enver Caka, Mimoza Hysaj, Myqerret Hebibasi, Skerdilajt Jaupllari, Valbona Gropa.

Vota KUNDËR: s'ka

Vota ABSTENIM: s'ka

**Pika 11 e rendit të ditës “Për miratimin e planit të masave për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në fondin pyjor e kullosor për vitin 2026, në bashkinë skrapar.”**

Kryetare Këshillit deklaroi shqyrtimin e projektvendimit

Me leje fjalën e mori znj.Hava Nuhellari i cila prezantoi projektvendimin sipas relacionit bashkëlidhur.

Kryetare Këshillit drejton pyetjen nëse ka pyetje diskutime rreth çështjes? jo

Kryetare e Këshillit deklaroi hapjen e votimit për miratimin e projektvendimit. Ora 11:10

Vota pro: : 9, Alma Kadiasi, Albana Hoxha, Edmond Kalem, Elsa Petritaj, Enver Caka, Mimoza Hysaj, Myqerret Hebibasi, Skerdilajt Jaupllari, Valbona Gropa.

Vota KUNDËR: s'ka

Vota ABSTENIM: s'ka

**Të ndryshme**

Fjalën e mori z.Myqerret Hebibasi i cili shpreh se është një zotëri në Zaloshnje ka nevojë për leje për të bërë shtëpi.

Nën/Kryetarja e Bashkisë znj.Sonila Hysenbelliu shpreh se Kryetari është në djeni të kësaj situatë dhe po e mer në konsideratë. Jemi duke punuar për të gjetur mundësinë për ta ndihmuar.

Kryetare e Këshillit e deklaroi përfundimin e mbledhjes .

Sekretare Këshillit Bashkiak: Xheni Çela

Kryetare Këshillit Bashkiak:

Këshilltarët që firmosin procesverbalin:

1. Alma Kadiasi

2. Fikret Telha

3. Skerdilajt Jaupllari

Elsa Petritaj

